Nr 2716/2 Prot
Dt 04.11.2021.

**PROCES VERBAL**

Mbajtur sot me datë: 04.11.2021, ora 10:00 në Njësinë Administrative Suç, për hartimin e projekt- buxhetit 2022 dhe Paketës Fiskale 2022.

Marrin pjesë: Kryetari i Bashkisë, Nën Kryetari, Nën Kryetarja, Përgjegjësja e Sektorit të Financës, koordinatorja për Median & Administratori i Njësisë.
Hap dë gjesën kryetari i Bashkisë.
Falenderon pjesëmarrësit & tregon arsyen për të cilën janë mbledhur në bazë të ligjit 139/2015.
Shprehet që duhet të jemi korrekt për shpërndarjen në mënyrë transparente të buxhetit.
Flet mbi investimin e realizuar në Fshatin Kurdari: KUZ e ndërtuar ka patur përfitime shumë të mëdha.
Shpjegon që buxheti i bashkisë është shumë i ulët për të kryer investime të mëdha, për që mund të merren financime edhe nga Ministritë e Linjës apo Fondi Shqiptar i Zhvillimit.
U kërkon banorëve të paraqesin problemet e tyre në mënyrë që të mbahen në konsideratë gjatë hartimit të buxhetit & paketës fiskale.
Flet për Azhornimin e Tokave të Sucit që është në proces & tregon që në zonën e Sucit realizohet edhe mbledhja e mbetjeve.
Flet Flamur Keci (Kryetar fshati) Kërkon ndërhyrje në Kanalin e vaditjes nga vepra e marrjes deri te tokat që vaditen.
Flet Luan Patlli: Paraqit kërkesën në lidhje me problematikën që ka rruga e Unazës të Shkolla & KUZ të shkolla deri te Gjoni ka nevojë për pastrim.
Duhet parë Tubina te rruga e Unazës që shkon te Shkolla.
Gjithashtu paraqet kërkesë për rrethimin e varrezave të Sucit.
Flamur Keçi: Kërkon një te varrezat.
Merr fjalën Dritan Keçi banor i fshatit Skënderaj. Paraqet problematikat e rrugës në këtë fshat.

Banorët shprehin shqetësimin në lidhje me ndërhyrjet e paligjshme që janë në ujësjellës (të bëra nga firma që e cila duhet diskutuar me firmën.)

Luan Patlli: Ka ankesë për taksat e pastrim-gjelbërimi, për vitet e mëparshme, kur nuk è ofruar ky shërbim.

Flet Lefter Kërciku, banor i fshatit Kuçtim, Ka kërkesë për ngelhimin e varrezave te xhamia e vjetër. Ai shpreh kërkesën për shtrimin e rrugën deri te xhamia

Luan Patlli: ka kërkese për shtimin e një punëtori te rreqë t e kesaj zone

Haris Berdi: Falenderon pjesëmarrësit & kërkon hapjen e rrugës te Berdi

Flet Eva Kaja: (infermiere e Suçit) kërkon mësuese ndihmëse që fëmijët autik të mos mbeten në shtëpi.

Mësuese Nertila Gjini shpreh kërkesën në lidhje me shkollën e Suçit.

Kryetari shprehet që do realizohet në v. 2022, jo nga Ministria e Rindërtimit, por nga Ministria e Arsimit.

Flet një banor i fsit Budiny që përveç kërkesës që ka për shkollën kërkon faliminëm për vendosjen e disa tubave në kanalin vaditës.

Gjithashtu, ka kërkesë për:
- Kosha mbeturinash në lagjen Halilaj.
- Tabela që të mos lejojnë kalimin e mjeteve të rënda, si & sinjalistikë

Flet Nard Doci i cili kërkon ndërhyrje në rrugë.

Në lidhje me paketën fiskale: Banorët kërkojnë që të rritet tarifa e ujit të pijshëm mbi një limit të caktuar (psh. deri 200m³ të ketë një çmim të caktuar, & mbi këtë sasi të ketë çmim më të lartë.

Përgjegjëse e Financës

Silvana Bala

[signature]

Koordinatore për Konsultimin Publik

Matilda Lleshaj

[signature]